R E L A C I O N

Mbi

Raportet e monitorimit viti 2024

Gjate vitit 2024, Gjykata e Lartë ka bërë planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e treguesve të buxhetit të miratuar në përputhje me objektivat e përcaktuara, duke zbatuar me përpikmëri legjislacionin në fuqi.

Fondi i vënë në dispozicion të Gjykatës së Lartë për këtë periudhë është në shumën 392281 mijë lekë. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi fond të celur në art. 606 " transferta për buxhet familjar dhe individë " shumën 1313 mijë lekë.

Buxheti i realizuar është 386297 mijë lekë, i detajuar si me poshtë:

Në 000 lekë

Artikulli	**Emertimi**	**Buxheti Viti 2024 Ne fillim**	**Buxheti i planifikuar per vitin 2024**	**Realizimi I viti 2024**
231	INVESTIME GJITHESEJ	4500	4500	3487
600	PAGA	315400	293130	292868
601	KONTR.SIG. SHOQERORE	35000	35000	33881
602	MALLRA DHE SHERB.TJERA	46000	58338	54755
606	TRANSFERIME PER BUXHET FAM & IND	220	1313	1306
		401120	**392281**	**386297**

ANEKSI nr.1" Raporti i shpenzimeve sipas Programeve" .

ANEKSI nr.2 "Raporti i Shpenzimeve te ë Programit në nivelin e Programit të Buxhetit".

Gjatë kësaj periudhe kemi mosrealizim në shumen -6044 mijë lekë me planin e parashikuar.

Sipas artikujve kemi mosrealizim në art.600 në shumën – 262 mijë lekë dhe art.601 në shumën -1119 mijë lekë.

Në art .602 kemi një diferencë mos realizimi në shumën prej -3583 mijë lekë.

Në zerin Shpenzime për mallra e shërbime, gjatë vitit 2024 planifikuar dhe një pjesë janë realizuar me procedure prokurimi "Blerje me vlerë të vogël" në mënyrë elektronike si dhe me procedure "me vlere nën 100 mijë lekë" : mirëmbajtje pajisjeve elektrike në shumën 516 mijë lekë, mirëmbajtje e pajisjeve teknike në shumën 818 mijë lekë,larje makinash 879 mijë lekë, mirëmbajtje ashensori 128 mijë lekë , blerje shtypshkrime 970 mije leke, blerje uniforma 213.6 mije leke, material pastrimi 561.4 mijë lekë, mirëmbajtje lulishte 99.5 mijë lekë, siguacion mjete

transporti 1485.4 mijë lekë , mirëmbajtje godine 600 mijë lekë, blerje goma makine 468 mijë lekë , mirëmbajtje gjeneratori në shumën 184.8 mijë lekë, mirëmbajtje sistem sigurie në shumën 468 mijë lekë, shërbim dizinfektimi 117 mijë etj, për të cilat jane lidhur kontrata respektive me afat deri 31.12.2024.

Shpenzime për honorare për anëtarët e KED-it gjatë vitit 2024 janë në shumën 3485 mijë lekë.

Përsa i perket realizimit të shpenzimeve në zerat e tjerë në artikullin 602, janë realizuar shpenzimet për karburant në shumën 7526 mijë lekë , taks qarkullimi automjete në shumen 521 mije, pjesë këmbimi 2353 mijë lekë, për shërbim printimi në shumën 3136 mijë lekë.

Shpenzimet për shërbime: energji elektrike 3067 mijë, uje 140.7 mijë, telefon 2386 mijë, postë 2123.6 mijë etj , te cilat jane realizuar sipas planifikimit buxhetor.

Po kështu janë realizuar shpenzimet për pritje, udhetim e dieta, kuotizacion, etj si me poshtë :

Shpenzime për pritje 1016 mijë , shpenzime kuotizacioni 778 mijë, udhëtime e dieta 3650 mijë, shpenzime për ekzekutim vendime gjyqësore në shumen 15078 mijë lekë, shpenzime avokat kryesisht 82 mijë.

Për këtë vit janë lidhur kontrata në vazhdim të procedurave "marrëveshje kuader" si më poshtë:

1-Mirembajtje mjete transporti shoqeria e shpallur fituese është firma " Auto servis 2000" .

2-Sherbim printimi, , shoqëria e shpallur fituese është firma " Infosoft Ofice".

3-Blerje karburanti shoqeria e shpallur fituese është firma " Gega Oil".

Në art 606 në këtë periudhë kemi celje fondi në "transferta tek individet" në shumen 1313 mijë lekë, për "ndihme ekonomike " të punonjësve të institucionit si dhe kompesim të shpenzimeve cellular.Janë shpenzuar 1306 mijë lekë.

Në artikullin 231 " kapitale të trupezuara janë planifikuar 4500 mije lekë:

Në fillim te vitit ishin planifikuar për blerje pajisje.Meqënënse gjykata pati nevojë për rikonstruksion të pjesshëm të godinës, u bë kërkesë për rialokim fondi e cila u miratua në shumën 3800 mijë lekë.

Pas rialokimit, detajimi i fondit është për Blerje Pajisje 700 mijë lekë dhe Rikonstruksion godine në shumën 3800 mijë lekë.

Realizimi për zërin "Bleje Pjisje" është në shumën 665 mijë lekë.

Për rikonstruksionin e godines është mbyllur procedura e prokurimit, eshte shpallur fitues operatori ekonomik " Martin konstruksion & Real Estate " shpk dhe realizimi për zërin rikonstruksion është 2822 mijë lekë.

ANEKSI Nr.3 'Raporti i performances se produkteve te programit

Në lidhje me produktin A ”Ceshtje te Gjykuara” shohim se kemi një rritje të lehtë të kostos krahasuar me vitin 2023, kjo si rezultat i ekzekutimeve të vendimeve gjyqesore si dhe uljes së numrit të cështjeve të gjykuara në vitin 2024.

Në produktin F “ Mobilje” kemi planifikuar 4500 mijë lekë për vitin 2024.

Për një pjesë të fondit për blerje pajisje është bërë kërkësë për rialokim fond nga zërin “Bleje Pajisje” në zërin “Rikonstruksion”dhe është miratuar kërkesa për 3800 mijë lekë.

Pas rialokimit të fondeve kemi :

Në produktin F “ Mobilje” kemi planifikuar 700 mijë lekë për vitin 2024.

Realizimi për zërin “Bleje Pjisje” është në shumën 665 mijë lekë.

Në produktin E “Rikonstruksion” kemi planifikuar 3800 mijë lekë.

Realizimi në zërin” Rikonstruksion” është në shumën 2822 mijë lekë.

ANEKSI 4. Produktet e investimeve me financim të brendshëm

Në aneks shohim se është planifikuar fondi 4500 mijë lekë per gjithë vitin 2024 .

Me kod projekti 18 AD801 “Mobilje –Pajisje” në Shumen 700 mijë lekë të cilat u realizuan në shumën 665 mijë lekë.

Me kod projekti M290068 “Rikonstruksion” në shumën 3800 mijë lekë, planifikuar për rikonstruksionin e godines së gjykatës dhe u realizua në shumën 2822 mijë lekë.

Nëpunësi Zbatues

Filloreta Ajdini